



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 114/4 Prot

Tiranë, më 04.05.2022

**V E N D I M**

Nr.60, datë 04.05.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të konkurrimit për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, të publikuara në faqen zyrtare të DAP-it, me kod #3726 dhe #3727, për pozicione pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ankesës së shtetasit \*\*\*\*\* , për tu vlerësuar drejt nga ana e KPP-së.

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është protokolluar një kërkesë e shtetasit \*\*\*\*\* , me nr. 114 prot., datë 21.01.2022, përmes së cilës ngrihet pretendimi se në përfundim të procesit të konkurrimit për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, të publikuara në faqen zyrtare të DAP, përkatësisht në kodet # 3726 dhe # 3727, nuk është vlerësuar drejt nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, prandaj kërkohet ndërhyrja e Komisionerit për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë duke marrë

masa për respektimin e parimit të shanseve të barabarta, parashikuar në nenin 20, të ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës me nr.1141/1 prot., datë 16.02.2022 ka kërkuar aktet e nxjerra nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me verifikimin e kërkesës së konkurrentit \*\*\*\*\* për disa pretendime në lidhje me procedurën e rekrutimit, në shpalljet me kod nr. # 3726 dhe # 3727, për pozicione pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme pranë Komisionerit ka ardhur shkresa me nr.174/1 prot., datë 01.03.2022 nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet të cilës është dërguar dokumentacioni i kërkuar dhe janë parashtruar argumentat ligjore për çdo pretendim të ngritur nga ankuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se konkurenti në fjalë ka aplikuar për grupin e pozicioneve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, shpallur me **kodet #3726**, - *Lloji i diplomës “Arsim i Lartë/ushtarak/policor/ShkencaInxhinierike/Shkenca ekonomike/Shkenca Natyrore/Shkenca Juridke”* dhe **#3727**– *lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/Shkenca Natyrore/Shkenca Inxhinierike” niveli minimal i diplomës “Bachelor”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Pas verifikimit paraprak nga ana e njësisë përgjegjëse, mbi plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe ato të posaçme të përcaktuara në shpalljet e sipërpërmendura, në zbatim të pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe kreut IV, të VKM nr. 243 “Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, ka rezultuar se shtetasi \*\*\*\*\* , është kualifikuar për fazën e dytë të konkurrimit, atë të testimit me shkrim, për të dyja procedurat e konkurrimit.

Në përfundim të procesit të konkurrimit dhe shpalljes së rezultateve nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, konkurenti \*\*\*\*\* , ka grumbulluar 45 pikë nga vlerësimi i testimit me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, duke u kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë. Intervista është zhvilluar në datën 10.12.2021, për procedurën e shpallur me kod # 3726 dhe në datën 09.12.2021 për procedurën e shpallur me kod #3727, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Pas kryerjes së intervistës dhe daljes së rezultateve përfundimtare, konkurrenti në fjalë nuk është shpallur fitues. Duke mos qenë dakort me vlerësimin, në zbatim të pikës 22, të Kreut IV, të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, në datën 17.12.2021, ka paraqitur ankesë pranë njësisë përgjegjëse brenda afateve ligjore të ankimit, duke kërkuar rivlerësim të testimit me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës së strukturuar me gojë, vetëm për procedurën me kod #3727, ndërsa për procedurën me kod #3726 nuk rezulton që kandidati të ketë paraqitur ankesë.

Komiteti i Përhershëm i Pranimin është mbledhur në datën 23.12.2021, për shqyrtimin e ankesës së paraqitur për procedurën #3727 dhe pas rivlerësimit të gjithë dokumentacionit të testimit dhe dosjes personale të konkurrentit \*\*\*\*\* , ka arritur në përfundimin që vlerësimi i mëparshëm ishte i drejtë. Përfundimisht, është konkluduar se ai kishte marrë **69 pikë nga 100 pikë të mundshme**, dhe për këtë është njoftuar me shkrim bashkë me procesverbalin përkatës të mbajtur nga anëtarët e KPP-së.

Bazuar në nenin 15 pika 3/c, të ligjit nr. 32, dt 2.04.2015 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë”i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike fitues të konkurrimit mund të shpallen vetëm: ...d) Kandidatët, që marrin mbi 70 % të pikëve totale të vlerësimit, të cilët renditen nga komiteti i përhershëm i pranimin, në listën e kandidatëve të suksesshëm.

Nga gjithë sa u thanë më sipër arrihet në përfundimin se njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimin, në rastin konkret kanë vepruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, duke kryer gjithë veprimet e nevojshme administrative për kryerjen e rregullt të procesit të konkurrimit për pranim nga jashtë në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, prandaj vlerësohet që procesi i verifikimit të përfundojë dhe çështja të arkivohet.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 109, germa d), neni 113 dhe nenin 114/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedurës administrative për vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të konkurrimit për pranim nga jashtë në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, në pozicionet e shpallura me kod #3726 dhe #3727, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe meqënëse veprimet e njësisë përgjegjëse gjenden në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave dhe shtetasi \*\*\*\*\*.
3. Personat e tjerë të interesuar, të marrin dijeni për këtë vendim nëpërmjet faqes zyrtare të KMSHC.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**